

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 27.11.2024*

27.11.2024

Ora, 11.04

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e raportit mbi gjetjet pas vlerësimit të regjistrimeve filmike gjatë implementimit të votimit elektronik në bashkitë Kamëz, Vorë dhe Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

Projektvendim “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Erin Pjeter Gjoni, anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Sociademokrate”.

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë: Devoll, Rrogozhinë, Lezhë, Kavajë, Krujë dhe Selenicë”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve


- Staf i KQZ: Znj. D. Alimemeti, znj. P. Doçaj, znj. L. Veliu

Parti Politike: Partia Demokratike (z. F. Nuri)

Të tjerë:

Z. I. Celibashi: Mirëdita! Atëherë në seancën e sotme publike, në rend dite kemi këto çështje: projektvendim “Për miratimin e raportit mbi gjetjet pas vlerësimit të regjistrimeve filmike gjatë implementimit të votimit elektronik në bashkitë Kamëz, Vorë dhe Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”. Projektvendim “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Erin Pjeter Gjoni, anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Sociademokrate”. Në vijim

**Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 27.11.2024*

kemi projektvendime që lidhen me krijimin e vakancave në këshillat bashkiakë, Bashkia Devoll, Bashkia Rrogozhinë, Bashkia Lezhë dhe Bashkia Kavajë, Bashkia Krujë dhe Bashkia Selenicë. Mirë, atëherë fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me vlerësimin e gjetjeve të raportit për implementimin e votimit elektronik në Bashkinë e Kamzës, Vorës dhe Elbasanit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Përfaqësuesi i Partisë Demokratike.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Faleminderit z. Celibashi! Unë kam ardhur pikërisht për pikën nr.1, pikën e parë të rendit të ditës, për t'ju kërkuar një shtyrje të afatit të shqyrtimit të kësaj pike, me një apo dy javë, do jetë një kohë e mjaftueshme sepse faktikisht njoftimi që kemi marrë si subjekt nuk ka qenë i përfshirë raporti në dijeninë time, por nuk kemi pasur mundësinë që të njihemi efektivisht me gjetjet. Do doja që të kishim pak kohë që t'i shikonim, t'i analizonim dhe të kemi dhe ne një qëndrim më konsequent me këto gjetje sepse votimi elektronik është një element i rëndësishëm sepse ka pasur tre bashki në zgjedhjet e 14 majit 2023, kur ne faktikisht kemi pasur kontestimet tona. Kemi dorëzuar edhe gjatë kontestimeve, pamjet filmike. Kështu që do donim që të njiheshim efektivisht me materialin e KQZ-së, me gjetjet dhe pse jo të kemi dhe ne mundësinë që në mënyrë efektive t'i sjellim, vërejtjet, sugjerimet dhe qëndrimin tonë. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Dakord, e gjej të arsyetuar kërkesën për shtyrje nga ana juaj. Kështu që do ta shtyjme shqyrtimin e kësaj çështje, për një javë ose ndoshta 10 ditë, për t'i vënë në dispozicion përfaqësuesve të Partisë Demokratike dhe partive të tjera dhe kujdo tjetër të interesuar për raportin dhe gjetjet përkatëse dhe çfarë dokumentacioni tjetër mund të konsiderohet si nevojë për t'i bashkëngjitur këtij raporti. Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës. Po, Pavlina.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 27.11.2024*

Znj. P. Doçaj: Në lidhje me pikën e dytë të rendit të ditës, kemi një kërkesë për shtyrje nga z. Erin Gjoni dhe nga subjekti zgjedhor që e ka propozuar si anëtar në këshillin bashkiak. Kanë kërkuar një shtyrje për sa e mendojmë ne, por jo ditën e sotme nuk mund të paraqitej.

Z. I. Celibashi: Dakord, e pranojmë edhe në këtë rast kërkesën për shtyrjen e shqyrtimit të çështjes. Mirë, atëherë vazhdojmë me projektvendimet që kanë të bëjnë me plotësimin e vakancave në disa këshilla bashkiakë.

Znj. P. Doçaj: Po, faleminderit! Këshilli i Bashkisë Devoll, Këshilli i Bashkisë Rrogozhinë, Këshilli i Bashkisë Lezhë, Këshilli i Bashkisë Kavajë, Këshilli i Bashkisë Krujë dhe Këshilli i Bashkisë Selenicë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancave në këshillat përkatës nga kandidatë të subjekteve zgjedhore të ndryshme. Referuar nenit 19, pika 2, e ligjit 10019 të Kodit Zgjedhor. Kemi kryer verifikimet përkatëse në listat shumëmemërore me kandidatët vijues të radhës, kandidatët kanë depozituar formularët e dekriminalizimit brenda afateve ligjore, nga verifikimi i të cilave kemi konstatuar që nuk kanë asnjë ndalim në parashikimet e ligjit 138/2015. Më pas Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion Zyrës së Gjendjes Civile dhe asaj Gjyqësore. Kemi marrë një përgjigje nga Drejtoria e Gjendjes Gjyqësore për të gjithë kandidatët nga ku rezulton se asnjë nga kandidatët nuk ka vendime penale të formës së prerë në ngarkim të tyre. Në mbështetje të nenit 2, të kreut V, të vendimit 17, të vitit 2016 të Kuvendit, konstatohet se të dhënat e kandidatëve nuk përbëjnë kusht për moszgjedhshmërinë e tyre, në funksionet e këshilltarit. Bashkëlidhur keni dhe projektvendimet përkatëse.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 27.11.2024*

Z. I. Celibashi: Po faleminderit Pavlina! Atëherë vendosim plotësim e vakancës në Këshillin e Bashkisë Devoll, me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Socialiste së Shqipërisë”, znj. Esmeralda Metolli. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Rrogozhinë, me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Socialdemokrate”, znj. Lorena Baku. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë, me kandidatin e listës shumemërore, të “Partisë së Unitetit Kombëtar”, znj. Gjyljana Seferaj. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kavajë me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Demokratike” znj. Meleqe Kazazi. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Krujë me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Ardhmëria Shqiptare”, z. Parid Miri. Dhe e fundit, plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Selenicë me kandidatin e listës shumemërore të “Partisë Aleanca Demokratike të Shqipërisë”, z. Robini Hodaj. Përfunduar, çështje të tjera nuk kemi në rend dite. Faleminderit, ditë të mbarë të gjithëve!

Vendimi nr. 196-201

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

